



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-76

PËR SHËNDETIN RIPRODHUES

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1(ë) dhe 9.1.26 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr.2001/9 e datës 15 Maj 2001).

Miraton:

LIGJIN PËR SHËNDETIN RIPRODHUES

Kapitulli I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj rregullon organizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha veprimtarive që zhvillohen në fushën e shëndetit riprodhues, në institucionet shëndetësore, mbron të drejtat riprodhuese të individit e të çiftit duke përfshirë të drejtën për tu informuar dhe për të pasur qasje në shërbime të duhura.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllimet e këtij Ligji vlejné përkufizimet e termeve nga Ligji për shëndetësi nr. 2004/4, Kapitulli I, neni 1 dhe përkufizimet e veçanta si vijon:

Shëndeti riprodhues: është gjendja e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale që përfshinë çdo gjendje që i përket sistemit riprodhues dhe që nuk definohet vetëm si mungesë e thjeshtë e sëmundjes, çrregullimit të funksionit ose të pamjaftueshmërisë.

Amësia e sigurt: nënkupton të drejtën që çdo femër të marrë kujdesin që i nevojitet të ketë shëndet të mirë nga shtatzënia deri në lindjen e fëmijës. Elementet kryesore për të siguruar amësinë e sigurt përfshijnë qasjen për kujdes me cilësi të lartë para, gjatë dhe pas lindjes.

E drejta riprodhuese: është e drejta e individëve dhe çifteve që të vendosin lirshëm dhe me përgjegjësi mbi numrin, shpeshësinë dhe kohën në të cilën ata duan të kenë fëmijë, të drejtën që të kenë qasje në informata, edukim, komunikim dhe mjete të cilat do t'iu mundësojnë atyre që vendimet të jenë të mbështetura në evidencë.

Planifikimi i familjes: është e drejta e individëve dhe çifteve që të informohen, të parashohin dhe vendosin lirshëm mbi numrin, shpeshësinë dhe kohën në të cilën ata duan të kenë fëmijë.

Kontracepcioni: nënkupton metodat dhe mjetet që përdoren për pengimin mbarësisht të qelizës vezë dhe zhvillimin e shtatzënisë.

Infertiliteti: paraqet redukimin e theksuar dhe i pavullnetshëm i kapacitetit natyror të riprodhimit të një çifti heteroseksual për të pasur fëmijë në moshën e pjekur biologjike riprodhuese, brenda dy viteve me jetë stabile seksuale të vërtetuar pa përdorim të kontracepcionit.

Riprodhimi i asistuar: është një kompleks i shërbimeve mjekësore që ka për qëllim të rregulloj infertilitetin përfshirë të gjitha trajtimet dhe procedurat e inseminimit artificial, fertilizimit in-vitro, procedurat laboratorike, veprimet mjekësore me materialet gjenetike femërore dhe mashkullore, me pikësynim të fekondimit artificial dhe vendosjen e embrioneve të fituara.

Inseminimi artificial: paraqet proces përmes së cilit sperma vendoset në ose afër organit riprodhues femëror, duke përdorur teknika të riprodhimit të asistuar mjekësor dhe jo marrëdhënie seksuale.

Fertilizimi in vitro: teknika e riprodhimit të asistuar mjekësor me fekondimin e qelizës vezë me gametin mashkullor që bëhet jashtë organizmit të femrës, në laborator, që rezulton me embrion i cili transferohet në mitër me qëllim të implantimit dhe të zhvillimit të tij në fryt.

Lehonia: periudha kohore prej 6 javë pas lindjes.

Menopauza: periudha e jetës së femrës në të cilën ndalet cikli menstrual.

Andropauza: periudha e jetës së mashkullit në të cilën ndërrohet balanci hormonal mashkullor.

Nëna bartëse: femra e cila pranon bartjen e embrionit të fituar nga riprodhimi human i asistuar mjekësor dhe implantimin e tij në mitrën e saj, mbajtjen e shtatzënisë së plotë dhe lindjen dhe e cila në mënyrë vullnetare heq dorë nga e drejta ligjore për fëmijën e lindur nga ky akt, duke u mbështetur në kontratën e bërë me çiftin infertil.

Neni 3

Ministria e shëndetësisë organizon dhe koordinon veprimtaritë në këto fusha të shëndetit seksual dhe riprodhues:

1. E drejta riprodhuese;
2. Informimi, edukimi dhe këshillimi mbi shëndetin seksual dhe riprodhues përgjatë gjithë ciklit jetësor;
3. Amësia e sigurt;
4. Planifikimi i familjes;
5. Parandalimi dhe trajtimi i përshtatshëm i infertilitetit;
6. Ndërprerja e sigurt e shtatzënisë;
7. Shërbimet për parandalimin dhe trajtimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme, HIV/AIDS-it, si dhe infeksioneve dhe sëmundjeve të traktit riprodhues;
8. Parandalimi, zbulimi i hershëm dhe trajtimi i sëmundjeve malinje të sistemit riprodhues dhe karcinomës së gjirit.

Kapitulli II E DREJTA RIPRODHUESE, INFORMIMI, EDUKIMI DHE KËSHILLIMI

Neni 4

4.1. Çdo individ i pavarësisht nga përkatësia gjinore, ideologjike, religjioze apo kulturore i garantohet e drejta në informim dhe edukim lidhur me shëndetin seksual e riprodhues, përgjatë gjithë ciklit jetësor të saj/tij.

4.2. Të gjithë individët dhe çiftet kanë të drejtën të vendosin lirisht, por duke respektuar dëshirën e secilit partner, për kohën, numrin e intervalin e lindjeve, të informohen për mjetet e duhura të realizimit të tyre.

4.3. Ky ligj i garanton çdo individ vendimmarrjen për ushtrimin e të drejtave riprodhuese sipas dëshirës dhe interesit të tyre të lirë nga diskriminimi, detyrimi dhe dhuna.

4.4. Respekti reciprok, mirëkuptimi, pacenueshmëria e integritetit personal dhe ndarja e përgjegjësive për sjelljet seksuale dhe pasojat e tyre janë obligim i dyanshëm i femrës dhe i mashkullit.

Neni 5

5.1. Çdo individ ka të drejtë në jetë të shëndoshë seksuale dhe riprodhuese që zgjedh me vullnetin e saj/tij.

5.2. Asnjë femër nuk mund të detyrohet të mbetet shtatzënë.

5.3. Çdo ndërhyrje mjekësore e lidhur me shëndetin seksual dhe riprodhues duhet bërë konform Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor nr. 2004/38.

Neni 6

6.1. Çdo individ i sigurohet qasja në shërbime shëndetësore të standardit më të lartë të mundshëm të shëndetit seksual dhe riprodhues, për të ruajtur dhe përparuar shëndetin seksual dhe riprodhues të saj, tij, dhe ka të drejtë të kërkojë këshillim, ekzaminim mjekësor, trajtim të përshtatshëm dhe rehabilitim për jetë të shëndetshme seksuale dhe riprodhuese konform Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor nr. 2004/38.

6.2. Të gjithë individët kanë të drejtë për të përfituar nga progresi shkencor dhe teknologjitë e reja lidhur me riprodhimin dhe seksualitetin, kur ato janë të sigurta dhe të pranueshme.

Kapitulli III AMËSIA E SIGURTË

Neni 7

Çdo femër ka të drejtë në amësi të sigurt.

Neni 8

8.1. Të gjitha femrat para dhe gjatë shtatzënisë, gjatë lindjes dhe në lehoni përfitojnë pa bashkë pagesë, në institucionet shëndetësore publike këto shërbime:

1. këshillimin preconceptional,
2. ndjekjen periodike dhe kujdesin shëndetësor në shtatzëni,
3. kujdesin shëndetësor gjatë lindjes,
4. ndjekjen periodike dhe kujdesin shëndetësor në lehoni,
5. Kujdesin për foshnjën.

8.2. Çdo femër ka të drejtën për mbrojtje shëndetësore gjatë shtatzënisë së saj, për asistencë gjatë lindjes dhe të përfitojë zbatimin e metodave e praktikave që minimizojnë rrezikun për shëndetin e saj ose shëndetin e fetusit, të të porsalindurit dhe fëmijës.

Neni 9

9.1. Numri dhe lloji i ekzaminimeve të rekomanduara për shtatzëna dhe periudha e kryerjes së tyre përcaktohen me akt nënligjor të Ministrisë së shëndetësisë.

9.2. Të gjithë punëtorët shëndetësor në institucionet shëndetësore që ofrojnë përkuqdesje për shtatzënë kanë për obligim të plotësojnë fletoren personale të shtatzënes dhe fletoren e fëmijës.

9.3. Përdorimi i dokumentacionit shëndetësor rregullohet me akt nënligjor.

Neni 10

Nëna dhe foshnja kanë të drejtë për kujdes shëndetësor dhe mbështetje të veçantë të nivelit më të lartë të mundshëm.

Neni 11

Kujdesin para dhe gjatë shtatzënisë, lindjes dhe lehonisë brenda detyrave dhe përgjegjësiave të tyre e ofrojnë mjekët specialist të gjinekologjisë dhe obstetrikës, neonatologjisë, pediatriisë, mjekët familjar, mamitë dhe infermierët familjar.

Kapitulli IV PLANIFIKIMI I FAMILJES

Neni 12

Të gjithë individët dhe çiftet kanë të drejtë të informohen për rreziqe, edukim dhe komunikim të mbështetur në evidencë, zgjedhje të vullnetshme dhe që të përfitojnë nga përdorimi i mjeteve dhe i metodave të sigurta, të përballueshme dhe të pranueshme të planifikimit të familjes.

Neni 13

13.1. Shërbimet këshillëdhënëse për planifikim të familjes ofrohen nga personeli shëndetësor ose social i trajnuar dhe në institucionet që sigurojnë konfidencë.

13.2. Është detyrë e punëtorit shëndetësor ose social në institucionet shëndetësore që të informoj individin ose çiftin lidhur me planifikimin e familjes.

Neni 14

Metodat dhe mjetet për planifikimin e familjes, të pranueshme për t'u përdorur, përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 15

Vetëm specialisti i gjinekologjisë dhe obstetrikës dhe mjeku familjar janë të lejuar që të përshkruajnë mjete kontraceptive ose të rekomandojnë përdorimin e mjeteve dhe teknologjive kontraceptive mjekësore.

Neni 16

Kontracepcioni kirurgjik dhe aplikimi i implanteve dhe dispozitivit intrauterin bëhen vetëm nga specialisti i gjinekologjisë dhe obstetrikës ose urologu.

Neni 17

17.1. Sterilizimi artificial është një metodë e ligjshme për planifikimin familjar dhe kryhet konform nenit 109 të Ligjit për shëndetësi.

17.2. Çdo individ ka të drejtën, në përputhje me dëshirat e veta, që t'u nënshtrohet metodave kirurgjike për sterilizim.

Kapitulli V RIPRODHIMI I ASISTUAR

Neni 18

Riprodhimi i asistuar i përgjigjet vullnetit dhe kërkesës prindore të çiftit për të pasur fëmijë duke trajtuar shkaqet mjekësore të infertilitetit ose për të penguar bartjen e sëmundjeve nga prindërit tek fëmija.

Neni 19

Zbatimi i teknikave të riprodhimit të asistuar kryhet nga ekipi i profesionistëve të licencuar nga Ministria e shëndetësisë:

1. kur çifti ka dështuar në përpjekjet për të pasur fëmijë për një periudhë prej së paku dy vjetësh deri në momentin kur kryhet riprodhimi i asistuar;
2. kur merret pëlqimi me shkrim për çdo cikël procedurash mjekësore nga individët dhe çifti i interesuar konform Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor nr. 2004/38.

Neni 20

Riprodhimi i asistuar përdoret në rastet kur:

1. metodat tjera të trajtimit të infertilitetit të femrës, mashkullit ose partnerëve nuk janë produktive ose të përshtatshme dhe nuk garantojnë rezultatin e dëshiruar;
2. rekomandohet parandalimi i bartjes së sëmundjeve gjenetike nga prindërit tek fëmija;
3. rekomandohet parandalimi i bartjes së sëmundjeve tjera që do të rezultojnë në vdekje të parakohshme, prapambetje mendore dhe, ose, pa aftësi të rëndë të fëmijës;
4. Konsiderohen si alternativë e vetme për të lindur fëmijë.

Neni 21

Riprodhimi i asistuar përfshin procedurat klinike dhe biologjike, të cilat mundësojnë:

1. inseminimin artificial,
2. fertilizimi in vitro,
3. transferimin e embrioneve,
4. teknikat tjera të barasvlershme që lejojnë riprodhimin jashtë procesit natyror.

Neni 22

Para se t'i nënshtrohet riprodhimit të asistuar, konform Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor nr. 2004/38, çifti përfitues duhet të:

1. informohet rreth suksesit ose dështimit të procedurave,
2. informohet për rreziqet për nënën dhe fëmijën,
3. vlerësojë motivimin e çiftit,
4. informohet për mundësitë ligjore të adoptimit të fëmijës dhe të drejtohet në institucionet sociale përkatëse.

Neni 23

Veprimtaritë e ndaluara në lëmin e riprodhimit të asistuar janë:

1. keqpërdorimi i embrioneve për qëllime komerciale, industriale dhe eksperimentale.
2. manipulimet gjenetike në embrione;
3. donacionet ilegale të embrioneve;
4. trafikimi i gameteve;
5. përzierja e gameteve;
6. marrëveshjet e ndërmjetësimit për amësi substitutive,
7. inseminimi post-mortem pa pëlqim me shkrim të partnerit;
8. thyerja e të drejtës së konfidencës së të dhënave mbi dhuruesit e gameteve;
9. aborti selektiv i embrioneve të gjinisë së caktuar;
10. zgjedhja e gjinisë së fëmijës, me përjashtim të rasteve me indikacione shëndetësore me pasojë për nënën dhe frytin dhe,
11. veprimtaritë shëndetësore konform nenit 46 të Ligjit për Shëndetësi.

Neni 24

24.1. Për koordinimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të riprodhimit të asistuar mjekësor, do të jetë përgjegjës Komisioni për riprodhim të asistuar mjekësor i formuar nga Ministria e Shëndetësisë.

24.2. Autoriteti dhe përbërja e Komisionit për riprodhim të asistuar mjekësor do të përcaktohet me akt nënligjor.

Neni 25

Kushtet dhe kërkesat për përdorimin e teknologjive riprodhuese të asistuara, inseminim dhe fertilizimin artificial, që rezultojnë me implant embrional, përcaktohen me akt nënligjor.

Kapitulli VI

INFEKSIONET SEKUALISHT TË TRANSMETUESHME DHE HIV/AIDS

Neni 26

Masat e parandalimit, mbikëqyrjes, diagnostikimi dhe trajtimi i infeksioneve seksualisht të transmetueshme me përjashtim të HIV/AIDS-it, duke u mbështetur në standardet dhe protokolet shëndetësore të përcaktuara në evidencë, aktet ligjore dhe nënligjore, ofrohen nga specialistët e:

1. shëndetësisë publike,
2. mjekësisë familjare,
3. dermatovenerologjisë,
4. gjinekologjisë dhe obstetrikës
5. urologjisë

Neni 27

Parandalimi, mbikëqyrja, diagnostifikimi, trajtimi dhe kujdesi i HIV/AIDS rregullohet me akt nënligjor.

Kapitulli VII ORGANIZIMI I SHËRBIMEVE TË SHËNDETIT SEKSUAL DHE RIPRODHUES

Neni 28

Ministria e Shëndetësisë përcakton organizimin, strukturën, menaxhimin, rregullat e funksionimit, politikat dhe strategjitë e shëndetit seksual dhe riprodhues.

Neni 29

Kujdesi për shëndetin seksual dhe riprodhues përfshinë:

1. shërbimet para dhe gjatë shtatzënisë, gjatë lindjes dhe në lehonë;
2. shërbimet për rritjen, zhvillimin dhe të ushqyerit e fëmijës;
3. shërbimet për shëndetin seksual dhe riprodhues të adoleshentëve dhe të rinjve;
4. shërbimet për shëndetin seksual dhe riprodhues të personave përreth periudhës së menopauzës, andropauzës dhe në pleqëri;
5. shërbimet e avokimit, informimit, edukimit dhe komunikimit mbi shëndetin seksual dhe riprodhues;
6. shërbimet e planifikimit të familjes;
7. parandalimin dhe trajtimin e infertilitetit dhe metodat e riprodhimit të asistuar;
8. trajtimin e infeksioneve dhe sëmundjeve të traktit riprodhues;
9. kontrollin dhe mjekimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme;
10. mbikëqyrjen dhe trajtimin e HIV/AIDS;
11. shërbimet e shëndetit riprodhues në raste emergjente.

Neni 30

30.1. Shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues ofrohen në institucione shëndetësore publike, mikse dhe private të licencuara, në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor.

30.2. Organizimi i shërbimeve të shëndetit seksual dhe riprodhues në nivelet e kujdesit shëndetësor rregullohen me akte nënligjore.

Kapitulli VIII KATEGORITË E VEÇANTA

Neni 31

Ministria e shëndetësisë iu siguron qasje në shërbime shëndetësore seksuale dhe riprodhuese të nivelit më të lartë të mundshëm këtyre personave:

1. adoleshentëve dhe të rinjve,
2. personave në menopauzë, andropauzë dhe në pleqëri në nevojë,
3. personave me aftësi të kufizuar,
4. personave të trafikuar,
5. personave të marginalizuar.

Neni 32

Personave të çvendosur dhe refugjatë në situata emergjente iu sigurohet qasje në shërbime shëndetësore seksuale dhe riprodhuese themelore të nivelit më të lartë të mundshëm.

Neni 33

Personave që vuajnë nga sëmundjet malinje të sistemit riprodhues dhe nga karcinoma e gjirit u sigurohet qasje në shërbimet e nivelit më të lartë të mundshëm të parandalimit, zbulimit të hershëm, trajtimit dhe mbikëqyrjes së sëmundjeve malinje në përputhje me akte nënligjore.

Kapitulli IX FINANCIMI

Neni 34

Shërbimet shëndetësore riprodhuese do të financohen konform nenit 57 të Ligjit për shëndetësi 2004/4.

Kapitulli X DISPOZITAT DISCIPLINORE DHE NDËSHKIMORE

Neni 35

35.1. Në rastet e mos zbatimit dhe shkeljeve të dispozitave të këtij ligji do të merren masa konform neneve 118, 119 dhe 120 të Ligjit për shëndetësi.

35.2. Shkelja e dispozitave ligjore të përcaktuara me këtë ligj paraqet vepër penale të paraparë sipas kapitullit 21 të Kodit Penal të Kosovës.

Kapitulli XI DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 36

Me qëllim të zbatimit të këtij Ligji, Ministria e shëndetësisë do të nxjerr akte nënligjore të përcaktuara me këtë Ligj.

Neni 37

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-76
10 tetor 2006

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Kolë Berisha